



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 537/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada- Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtare, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet Ardian Shala nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, e paraqitur kundër Këshillave të vendvotimeve (KVV) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të vendosjes gabimisht të votave, për shkak të parregullsive në Qendrën e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 01.03.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e pa lejuar ankesa Anr.537/2021 e datës 26.02.2021, e kandidatit për deputet Ardian Shala nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja, të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin 2430A/01R në Bukosh-Suharekë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

## **A r s y e t i m**

Me datë 26.02.2021, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.537/2021, e paraqitur nga kandidati për deputet Ardian Shala nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kundër Këshillave të vendvotimeve (KVV) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën pretendon se në vendvotimin 2430A/01R në Bukosh-Suharekë, kanë ndodhur parregullsi tek numërimi i votave dhe regjistrimit të tyre në FRP dhe FRK. Parashtruesi i ankesës pretendon se në vendvotimin 2430A/01R në Bukosh-Suharekë, janë vendosur gabimisht votat e kandidatit me nr.16 te kandidati me nr.15, ndërsa votat e kandidatit me nr.17 te kandidati me nr.16. Ky gabim kandidatit Ardian Shala i kushton 33 vota më pak. Më tutje kërkojnë nga PZAP-i që të urdhërohet rinumërimi i këtij vendvotimi dhe të korrigjohet gabimi në këto çështje.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

## **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet e përmendura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës Ardian Shala, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: “*ankesa të cilat janë të pa lejuara dhe të pas afatshme PZAP-i, i hudhë si të pa lejueshme*”, pra ankesa në këtë rast është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6, paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.537/2021 më datën 01.03.2021**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*